



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS

KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 48, dt. 11.03.2016

Në mbështetje të nenit 47 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.03.2016, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratimin e projektit “Linja e transmetimit 2x110 kV Ulëz-Shkopet-Skuraj”, kërkesë e OST.
2. Gjatë procesit të zbatimit të projektit, siç parashikon dhe legjislacioni për trashëgiminë kulturore, punimet të mbikqyren sipas nenit 48 të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

MIRELA KUMBARO FURXHI



SEKRETAR I KKR

ARTA DOLLANI